



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0040771-5/24 dt. 26.06.2024
Mitrovicë

02 No. Protokoll/Prosti 02-060/01-0040771-5/24
Nr. Liq./Liste
Date/Çmimi 26.06.2024
Shtet/State Mitrovicë - Mitrovica

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 40 pika j, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); në zbatim të nenit 6 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1 dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal; neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 4, 35, 36 paragrafi 1, dhe 37 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 26.06.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës Mitrovicës së Jugut për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.
2. Bashkëpunimi ndër komunal i komunës së Mitrovicës së Jugut do të zhvillohet me komunitat si në vijim:
 - 2.1 Komuna e Vushtrrisë
 - 2.2 Komuna e Obiliqit
 - 2.3 Komuna e Prishtinës
 - 2.4 Komuna e Podujevës
3. Nisma e bashkëpunimit ndër komunal me komunitat e cekura në pikën 2 të këtij vendimi ka për qëllim realizimin e projekteve me interes të përbashkët. Nisma për financim të përbashkët të studimit të fizibilitetit si dhe hartimit të projektit detaj/zbatues për ndërtimin e rrugës Barilevë-Kozaricë - Dumnice e Epërme - Kunovik - Vesekoc - Kurillovë - Bajgorë, rrugë me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe të agroturizmit në malet e shalës.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunitat e cekura në pikën 2 të këtij vendimi për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për shërbime publike dhe infrastrukturë

Drejtorisë për ekonomi, zhvillim, turizëm dhe integritet evropiane